



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
MUZEU HISTORIK KOMBËTAR  
DREJTORI

Nr. 254/16 Prot.

Tiranë, më 07 . 08 . 2025

Lënda: Përfundimi i procedurës së rekrutimit për pozicionin vakant "Specialist në Sektorin e Konservimit të Koleksioneve"

Z.KRENAR CURRI  
SPECIALIST NË SEKTORIN E KONSERVIMIT TË KOLEKSIONEVE

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe në përputhje me strukturën dhe organikën e miratuar të institucionit, si dhe me Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Brendshëm të Muzeut Historik Kombëtar, miratuar me Urdhrin nr. 509, datë 09.12.2020, është ndjekur procedura e rregullt e rekrutimit për pozicionin vakant "Specialist në Sektorin e Konservimit të Koleksioneve".

Pozicioni "Specialist në Sektorin e Konservimit të Koleksioneve", u shpall publikisht më datë 01.07.2025, me afat për dorëzimin e aplikimeve deri më 14.07.2025, në përputhje me rregullat e transparencës dhe të barazisë në trajtimin e kandidatëve.

Me Urdhërin nr. 49, datë 14.07.2025, u ngrit Komisioni i Vlerësimit për të shqyrtuar dokumentacionin dhe për të ndjekur procedurat përkatëse të konkurrimit. Brenda afatit të përcaktuar ligjërisht u paraqitën 5 (pesë) kandidatë, nga të cilët, pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, 2 (dy) kandidatë u kualifikuan për fazën pasuese të vlerësimit përmes provimit me shkrim, i zhvilluar më datë 06.08.2025, në ambientet e institucionit.

Provimi është administruar në përputhje të plotë me parimet e ligjshmërisë, barazisë, objektivitetit dhe konfidencialitetit, si dhe me kërkesat specifike të vendit të punës. Pyetjet janë hartuar duke u mbështetur në profilin profesional të pozicionit dhe kërkesat e përshkruara në shpalljen publike.

Përsa më sipër, në cilësinë e Titullarit të institucionit, pasi konstatova, kryerjen dhe përfundimin e një procesi të rregullt administrativ dhe ligjor, të kryer nga komisioni i vlerësimit si dhe referuar relacionit me Nr.254 Prot, datë 06.08.2025 "Mbi përfundimin e procedurës së rekrutimit për pozicionin vakant " Specialist në Sektorin e Konservimit të Koleksioneve", vendosa:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
MUZEU HISTORIK KOMBËTAR  
DREJTORI

1. Të shpall fitues kandidatin aplikant z.Krenar CURRI, për pozicionin e punës “Specialist në Sektorin e Konservimit të Koleksioneve”.
2. Ngarkohet punonjësi në detyrë i arkiv/protokollit për dorëzimin e këtij njoftimi.

Ky njoftim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI

Elenita ROSHI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR  
PËRGJEGJËS I SEKTORIT TË MENAXHIMIT TË KOLEKSIONEVE  
Andre LLUKANI

